



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 13 dhe 16 të Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 2003/14, të datës 3.7.2003, i fuqizuar me Rregulloren nr. 2003/30, të dispozitave të nenit 9 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, nr. 3/L -106 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 42 /2008), nenit 17 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), nenit 16, pika 16.1, shkronja **b**, dhe të nenit 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.3.2009, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TE PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Neni 1

Me këtë Vendim fillohet hartimit të Planit zhvillimor të Komunës së Prishtinës për periudhën 2010 - 2020.

Neni 2

Plani zhvillimor i Komunës së Prishtinës, përfshinë territorin e përcaktuar me Ligjin për kufijtë administrativ të komunave, nr. 3/L-041, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 26/2008), në kuadër të të cilit hyjnë qyteti i Prishtinës dhe fshatrat.

Neni 3

Plani, nga neni 1 i këtij Vendimi, përmban pjesën tekstuale dhe grafike.

Pjesa tekstuale Planit përmban: profilin e zhvillimit hapësinor, analizën e gjendjes, vizionin, parimet dhe caqet, kornizën e zhvillimit hapësinor, strategjitë dhe veprimet për zbatimin e këtij Plani.

Pjesa grafike e Planit përmban të dhënat hartografike dhe shtojcat tjera grafike, në të cilat paraqitet gjendja dhe ndërhyrjet në hapësirë, tërësia e zgjedhjeve të planifikuara dhe territori që është përfshirë brenda këtij Plani.

Neni 4

Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të këtij Plani, sipas këtij Vendimi, është promovimi i zhvillimit dhe planifikimit racional hapësinor, harmonizimi i drejtpeshimit në mes të zhvillimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve të hapura, mbrojtjes së mjedisit, zonave të veçanta të parapara me Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura nr. 03/L - 039 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr 28/2008) dhe krijimit të regjimit të planifikimit hapësinor dhe urban në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Neni 5

Bartëse e hartimit të Planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, është Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Për hartimin e Planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Komuna mund të ngarkojë agjenci dhe subjekte të tjera, të specializuara dhe të certifikuara për hartimin e planeve hapësinore.

Neni 6

Plani zhvillimor i Komunës do të jetë në përputhje me Planin hapësinor të Kosovës. Para finalizimit të këtij Plani, Komuna do të vë draftin në dispozicion të publikut dhe të agjencive, departamenteve e subjekteve të tjera për shqyrtim dhe komente në afatin prej 60 ditësh.

Neni 7

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor, në afatin prej 30 ditësh, do të japë pëlqimin në planin zhvillimor të Komunës. Në të kundërtën, nëse Ministria nuk e jep pëlqimin, ajo do të japë arsytet me shkrim për shkaqet e mosdhënies së pëlqimit.

Neni 8

Mjetet financiare dhe mjetet tjera të punës, të nevojshme për hartimin e Planit, sipas këtij Vendimi, janë të siguruara nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 9

Për zbatimin e Planit, sipas këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës. Organet tjera kompetente të Komunës së Prishtinës, do t'i kryejnë veprimet procedurale nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara me Statut, për zbatimin e këtij Plani.

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.35-494, më 12.3.2009

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Mustafa